

## TAKIMI I TRETË 2025 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **24.09.2025**.

Mbledhja u hap me prezantimin e përfaqësuesit të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional lidhur me ofertën arsimore për vitin e ri shkollor 2025 - 2026 në shkollat e TIK në rang kombëtar. Përfaqësuesi i ministrisë informoi se, për vitin shkollor 2025 - 2026 në arsimin profesional ishin regjistruar gjithsej rreth 15 400 nxënës, nga të cilët 777 në drejtimin TIK. U bë e ditur se, kishte pasur zhvillime në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, me kualifikime të reja, duke ofruar kështu 149 kualifikime në total, nga të cilat 92 prej tyre ofrohen aktualisht në shkolla.

Përfaqësuesi i ministrisë theksoi se, sfidat kryesore për shkollat e TIK mbeteshin: mungesa e pajisjeve teknologjike, zhvillimi i burimeve njerëzore (mungesë e burimeve njerëzore të kualifikuara), burimet e pakta financiare, mungesë infrastrukture, nevoja për përshtatje të vazhdueshme me tregun e punës dhe përfshirja e IA.

Gjatë diskutimeve mes anëtarëve u theksua se, gjatë 2-3 viteve të fundit, kërkesa e tregut të punës kishte pësuar ndryshime, ku nga mungesa e mëparshme e programuesve dhe tepërica e asistentëve administrativë, momentalisht vërehej tepëriçë programuesish dhe mungesë asistentësh administrativë. Nisur nga kjo anëtarët gjykuan të domosdoshme studimin e vazhdueshëm dhe të thelluar të nevojave për aftësi të tregut të punës për sektorin TIK. U theksua se, mosleximi në kohë i ndryshimeve të tregut sillte mospërputhje mes ofertës dhe kërkesës për forcë punëtore. U nënvizua gjithashtu se, inteligjenca artificiale përbënte një aftësi dhe instrument të rëndësishëm, i aplikueshëm nga profesione të ndryshme dhe jo vetëm nga sektori TIK.

Kryetari i Komitetit theksoi domosdoshmërinë e njohjes së qartë të nevojave të tregut përpara përcaktimit të kualifikimeve, për të shmangur formimin e profesionistëve pa perspektivë punësimi, si dhe nevojën për të analizuar paradoksin mes rritjes së numrit të kompanive IT dhe mungesës së kërkesës për punonjës. Në përfundim të këtij diskutimi u theksua nevoja për rishikimin e përmbajtjes së kualifikimeve profesionale, si dhe përgatitja e Studimit të Nevojave për Aftësi që përfshin edhe sektorin TIK, i cili do të shërbejë si bazë për diskutime dhe vendimmarrje të mëtejshme.

Në vijim të agjendës, anëtarët u informuan se, Shkolla Teknike Ekonomike e Tiranës ofronte dy drejtime kryesore: **“Ekonomi - Biznes”** dhe **“Tekstil - Konfeksione”**, ku drejtimi **“Ekonomi - Biznes”** kishte numrin më të madh të nxënësve dhe të kualifikimeve të ofruara. Drejtoresha e Shkollës Ekonomike Tiranë, informoi se, nga kërkesa e bizneseve, nxënësve dhe prindërve dilte

nevoja për përmirësimin ose shtimin e ofertës ekzistuese. Shkolla Ekonomike Tiranë me mbështetjen e projektit S4J kishte realizuar një studim tregu ku ishte evidentuar nevoja për një kualifikim të ri **“Tregti E-commerce”**.

Drejtoresha e Shkollës Ekonomike Tiranë prezantoi në mënyrë të detajuar nevoja e tregut, fokusin e kualifikimit profesional dhe mënyrat e mundshme të ofrimit të tij, duke theksuar se arsyeja e paraqitjes në Komitetin Sektorial lidhej me kombinimin e fortë të këtij profili me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Sipas studimeve, kualifikimi profesional **“Tregti E-commerce”** kishte një peshë rreth 60 - 70% njohurish ekonomike dhe 30 - 40% njohurish TIK. Drejtoresha e Shkollës Ekonomike Tiranë theksoi se, **“Tregti E-commerce”** ishte në rritje të vazhdueshme globale dhe përbënte hapin e radhës në rritjen e eficiencës së shitjeve, përtej moduleve ekzistuese të marketingut digjital.

Në përfundim të prezantimit anëtarët diskutuan mbi ndikimin e kualifikimit të ri **“Tregti E-commerce”** në raport me kualifikimin ekzistues **“Tregti”** dhe mundësia e mbivendosjes mes tyre. Anëtarët theksuan se, kualifikimi profesional **“Tregti E-commerce”** nuk kufizohej vetëm në përdorimin e platformave digjitale, por përfshinte menaxhimin e plotë të proceseve tregtare, shitjeve, klientëve, logjistikës dhe elementëve ligjorë e të sigurisë digjitale. U diskutua mundësia që **“Tregti E-commerce”** të ofrohej si një kualifikim i strukturuar në mënyrë graduale, si specializim pas marrjes së bazës në **“Tregti”**. Në përfundim, Komiteti Sektorial vlerësoi kualifikimin si të nevojshëm dhe në përputhje me nevojat e tregut.

Në vijim mbledhja u përqëndrua në diskutimin për **“Fotografinë digjitale”** dhe kualifikimet e lidhura me IA.

Komiteti u informua nga përfaqësues të AKAFPK-së mbi kërkesën e ardhur nga AKPA për hartimin e një kursi të unifikuar për **“Fotografi Digjitale”**, i cili ofrohej nga Qendrat e Formimit Profesional si kurs i veçantë, pa evidencë të qartë mbi kërkesën e tregut. Përfaqësuesi i AKAFPK-së theksoi se, kurset e unifikuara duhet të jenë pjesë e një kualifikimi afatgjatë, ndërkohë që aktualisht nuk ekzistonte një kualifikim i tillë specifik për **“Fotografinë Digjitale”**.

U diskutua mundësia e integritit të kursit në kualifikimin ekzistues **“Multimedia”**, niveli IV në KSHK, por u evidentua se, ky kualifikim nuk mund të shërbente si bazë për kurs të unifikuar për shkak të strukturës dhe lidhjes me TIK.

Pas diskutimeve, anëtarët dolën në konkluzionin se, **“Fotografia Digjitale”** lidhej më shumë me fushën e artit sesa drejtpërdrejt me TIK, pavarësisht përdorimit të elementeve digjitale. U theksua nevoja për vlerësim nga fusha e artit dhe për informacion më të detajuar mbi nevojat e tregut, përfitimet ekonomike dhe kontigjentet përkatëse. Komiteti vendosi që kërkesa për kurs të unifikuar të mos miratohej në këtë fazë dhe të kërkohej informacion shtesë nga pala propozuese.

Në vijim, u diskutua rishikimi i kualifikimeve të TIK dhe modaliteti aktual i ofrimit 2 + 2. U ngrit çështja e përshtatshmërisë së punonjësve gjysmë të kualifikuar me nevojat e tregut dhe u shpreh dakordësi që kualifikimet të shqyrtoheshin për ofrim në modalitetin 4-vjeçar bllok, për të rritur përgatitjen dhe punësimin e nxënësve.

Në lidhje me Inteligjencën Artificiale, u theksua se, në këtë fazë nuk ishte e përshtatshme krijimi i kualifikimeve të veçanta, por u rekomandua integrimi i IA në kualifikimet ekzistuese të TIK, duke përfshirë përdorimin praktik, aspektet etike, rreziqet dhe kufijtë e përdorimit.

➤ **Vendime të marra nga mbledhja:**

- Kualifikimi **“Tregti E-commerce”** u konsiderua i nevojshëm dhe i domosdoshëm, ndërsa forma dhe mënyra e lëvrimit do të përcaktoheshin në konsultim me ekspertët e fushës.
- U rekomandua sigurimi i informacionit shtesë lidhur me nevojat e tregut, objektivat strategjikë, nevojën prioritare dhe arsyetimin e detajuar, për të gjykuar dhe vlerësuar mundësinë e ofrimit të një kualifikimi afatshkurtër për **“Fotografi Digjitale”**.
- U vendos që kualifikimet ekzistuese në fushën e TIK-ut: **“Programim”**, **“Zhvillim website”**, **“Multimedia”**, **“Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”** dhe **“Rrjete të dhënash”** të rishikoheshin dhe të ofroheshin në strukturën 4 vjeçare bllok.
- U vendos që Inteligjenca Artificiale (IA) të integrohej në të gjitha kualifikimet ekzistuese të TIK-ut.